



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

NR. 57, DATË 29. 09. 2022

**“PËR NGRITJEN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
KËSHILLIT VENDOR RINOR”**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 29. 09. 2022, pasi mori në shqyrtim projektaktin e hartuar nga Drejtoria e Shërbimit Social, Arsimit, Sportit, Kulturës dhe Rinisë në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 54, gërma "m", Ligjit Nr. 75/2019, "Për Rininë", Kreu II, neni 7, neni 10, Këshilli vendor i rinisë, gërma: "a", "b", "c", "ç" Kompetencat, si dhe Vendimit Nr. 969, datë 02. 12. 2020, "Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave të zgjedhjes së anëtarëve të këshillit kombëtar të rinisë, si dhe të mënyrës së organizimit e të funksionimit të tij"

VENDOSI:

1. Ngritjen e Këshillit Vendor Rinor si organ këshillimor, që funksionon pranë Kryetarit të Bashkisë Skrapar.
2. Këshilli vendor i rinisë kryesohet nga kryetari i bashkisë dhe përbëhet nga 6 anëtarë:
 - *Kryetari i Bashkisë
 - * Drejtori i Drejtorisë së Shërbimit Social, Arsimit, Sportit, Kulturës dhe Rinisë
 - *Përfaqësues të Qeverisë së Nxënësve
 - *Përfaqësues të tjerë
3. Anëtarët e këshillit vendor të rinisë emërohen me urdhër të kryetarit të bashkisë.
4. Kriteret, procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë, të bëhet sipas Vendimit Nr. 969, datë 02. 12. 2020, si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të këshillit vendor të rinisë miratohen me vendim të këshillit bashkiak, duke iu referuar, për aq sa është e mundur, kriterëve dhe procedurave të miratuara nga Këshilli i Ministrave për Këshillin Kombëtar të Rinisë.



5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Drejtoria e Shërbimit Social, Arsimit, Sportit, Kulturës dhe Rinisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikes 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Vendimi u miratua me 11 vota pro , vota kundër - s'ka , votë abstenim – s'ka.

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .

KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK
Edlira SHKËMBI

